



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 81

Prishtinë, më 21.06.2013, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N- 303

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Fatmir Xhelili, Goran Marinković, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Danush Ademi

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Naim Hoxha, këshilltar nga OSBE-ja, Sanije Berisha, OSBE; Luanda Domi, DCAF, Besnik Ramadanaj, KDI, Venera Gashi-praktikante,

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli, Zarife Aliu dhe Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi i realizimit të planit të punës së Komisionit për gjashtë mujorin e parë të vitit 2013;
3. Të ndryshme;

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me një pikë shtesë.

Pikë e tretë e rendit të ditës, Informata e Drejtorit të Policisë së Kosovës me rastin e suspendimit të disa zyrtarëve policor me rastin e vizitës së zyrtarit serb, z. Aleksandër Vulin.

2. Shqyrtimi i realizimit të planit të punës së Komisionit për gjashtë mujorin e parë të vitit 2013.

Kryetari i Komisioni- Vlerësoi se shumica e obligimeve që janë paraparë në planin e punës për gjashtë mujorin e parë janë realizuar. Duke filluar nga muaji janar, Raporti vjetor i punës së Komisionit për vitin 2012, plani i punës së Komisionit për vitin 2013, punëtori lidhur me zbatimin e planit të punës, projektligji për Agjencinë e Regjistrimit Civil janë aktivitetet të realizuara.

Ndërsa Projektligji për Përgjimin e Telekomunikimeve është shqyrtuar nga ana e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe mbikëqyrje të FSK-së, si dhe në Komisionin për mbikëqyrjen e AKI-së, por ky projektligj është tërhequr nga ana e Kryeministrit, ndërsa Projektligji për dërgimin e FSK-së jashtë vendit është aprovua.

Aktivitetet e realizuara gjatë muajit shkurt janë, dëgjimi publik për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për IPK-në, takim pune për projektligjin për Komisionarin për Policinë e Kosovës dhe FSK-në, i cili është proceduar në Kryesin e Kuvendit dhe i është drejtuar Qeverisë, shqyrtimi i zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili është në procedurë, Raporti me rekomandime për zbatimin e Ligjit për Inspektoratin Policor dhe raporti me rekomandime për Projektligjin për Agjencinë e Regjistrimit Civil është aprovuar.

Shqyrtimi i Raportit vjetor i Policisë së Kosovës për vitin 2012 dhe shqyrtimi i raportit vjetor të punës për vitin 2012 për Inspektoratin Policor të Kosovës është realizuar në Komision. Gjithashtu edhe vizita në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave është realizuar.

Aktivitete e parapara për muajin mars, vizita zyrtare në Kuvendin e Shqipërisë është shtyrë për më vonë për shkak të zgjedhjeve që kanë qenë në Shqipëri, Raporti me rekomandime për dërgimin e FSK-së jashtë vendit është aprovuar nga ana e Komisionit, vizitë në Komandën e Forcave Tokësore të FSK-së, është bërë nga ana e disa anëtarëve të Komisionit. Mbikëqyrja e procesit të gradimit në Policinë e Kosovës është në proces, ndërsa vizita në FSK dhe përdorimi i armëve nga ana e tyre, nuk është realizuar kjo, por do të parashihet në muajt që vijnë.

Aktivitetet e parapara në muajin prill, shqyrtimi i Raportit Vjetor të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është realizuar, ndërsa vizita në Policinë e Kosovës është bërë nga disa anëtarë të Komisionit gjithashtu edhe në Qendrën e Situatave është realizuar një vizitë e tillë.

Aktivitetet e parapara nga Komisioni për muajin maj, Mbikëqyrja e shpenzimeve dhe menaxhimi financiar nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policisë së Kosovës si dhe mbikëqyrja e çështjeve lidhur me masat disiplinore ndaj pjesëtarëve të policisë, duke bashkëpunuar me IPK-në, është duke vazhduar.

Vizitë në Brigadën e Mbrojtjes Civile të FSK-së, nuk është realizuar, vizitë në Rugovë për demarkacionin kufitar mes Kosovës dhe Malit të Zi, nuk është realizuar, ndërsa takim me Avokatin e Popullit do të realizohet në të ardhmen si Komision, ndërsa është realizuar vizitë nga ana e grupeve punuese në kuadër të Komisionit.

Aktivitetet e parapara për muajin qershor, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-069 për të Huajt, nuk ka ardhur edhe në Komision nga Qeveria. Shqyrtimi i projektbuxhetit dhe rishikimin e buxhetit të ministrisë së resorit përkatës, shqyrtimi dhe miratimi i tij në Kuvend, përfshire edhe amendamentet, mbikëqyrja e zbatimit të ligjit për kontrollin kufitar, nuk është realizuar akoma, ndërsa vizita në pikën kufitare 1 dhe 31, duhet të shihet mundësia që në ditët në vijim të realizohet. Ndërsa për aktivitete të tjera që janë parapara në plan të punës mund të plotësohen.

Ganimete Musliu- Duke iu referuar planit të punës, disa aktivitete të parapara në emër të Komisionit janë realizuar nga ana e grupeve punuese, propozoj që në rastet kur këto vizita bëhen nga ana e grupeve punuese të behet raportim nga ana e tyre në Komision.

Kryetari i Komisionit- Pajtohem që vizitat që bëhen nga ana e grupeve punuese në institucionet e caktuara, të informohet Komisioni, edhe pse kjo është bërë në kuadër të raportimit në kuadër të mbikëqyrjes së ligjeve.

Rexhep Selimi- Theksoi se vizitat që bëhen nga ana e grupeve punuese në institucionet përkatëse bëhet në kuadër të aktivitetit mbikëqyrës të ligjeve dhe se këto vizita përfshihen në raporte, siç është raporti me rekomandime për mbikëqyrjen e ligjit të IPK-së. Ndërsa sa i përket realizimit të planit të punës për gjashtë mujorin e parë, nga punëtoria që është mbajtur për realizimin e tij, mund të mos realizohet komplet, por do të varet nga dinamika e krijuar, por deri në këtë muaj plani duket të jetë objektiv në realizimin e tij.

Ndërsa sa i përket shqyrtimit të Projektligjin për Përgjimin e Telekomunikimeve, Komisioni i është qasur mirë kësaj çështje, duke analizuar dhe argumentuar që ky projektligj nuk duhet të kalojë në seance, për shkak të mangësive që kishte ky ligj dhe se ky projektligj është tërhequr nga Qeveria.

Gjithashtu e vlerësoi si pozitive procesin e mbikëqyrjes së Ligjit të IPK-së dhe të gjeturat gjatë kësaj mbikëqyrje të cilat do të shërbejnë institucioneve përkatëse, si dhe projektligji për Komisionarin për Policinë e Kosovës dhe FSK-në, e konsideroi së një të arrirë, për të cilin projektligj komisioni ka qene hartues. Në mbyllje propozoi që aktivitete që nuk janë realizuar në gjashtë mujorin e parë të bartën në gjashtë mujorin e dytë.

Kryetari i Komisionit- Theksoi se aktivitete që bëhen nga ana e grupeve punuese bëhen në emër të Komisionit, gjithashtu nga ana e tyre duhet të bëhen njoftime, ndërsa konsideroj se agjenda e paraparë për gjashtë mujorin e parë është realizuar mirë.

3. Informata e Policisë së Kosovës lidhur me suspendimin e zyrtarëve policor me rastin e vizitës së zyrtarit serb, z. Aleksandër Vulin në Kosovë.

Kryetari i Komisionit- Nga takimi i kaluar është shpërndarë për anëtarët e Komisionit kjo informatë dhe mund të diskutohet, por me që disa nga anëtarët nuk e posedojnë tani mund ta lejmë për takimin e radhës.

Fatmir Xhelili- Tha se nga mbledhja e kaluar është shpërndarë kjo informatë për anëtarët e Komisionit, por propozoi që të jetë pikë e rendit të ditës në mënyrë që të mund të diskutohej.

Kryetari i Komisionit- Shqyrtimi i informatës nga Policia e Kosovës për suspendimin e disa zyrtarëve policor me rastin e vizitës në Kosovë të z. Vulin, mbetet për mbledhjen e radhës së Komisionit.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit- Theksoi Raportin e Departamentit të Shtetit Amerikan për nivelin e angazhimit të institucioneve të Kosovës lidhur me terrorizmin, ku theksohet se *“Qeveria e Kosovës për vitin 2012, ka shënuar përparim në luftën kundër terrorizmit. Sipas këtij raporti gjendja në veri të Kosovës e pa mundëson shtrirjen e autoritetit të institucioneve vendore në këtë rajon, ku KFOR-i dhe EULEX-i janë përgjegjës për ruajtjen e një mjedisi të qetë dhe të sigurt dhe përforcimin e sundimit të rendit dhe ligjit përfshirë edhe atë në kufi”*.

Ndërsa sa i përket trafikimit me qenie njerëzore, ka vërejtje pasi kemi të bëjmë me një dukuri e cila është në rritje, ku të përfshirë janë edhe qytetarët e Kosovës thuhet në raport. Gjithashtu në këtë raport thuhet se” *Qeveria e Kosovës nuk përmbush as standardet minimale për eliminimin e trafikimit, megjithatë bëhen përpjekje për të arritur këtë qëllim. Pavarësisht njoftimeve për raste për bashkëpunimin në trafikim të zyrtarëve të Qeverisë, asnjë zyrtar nuk është dënuar për këtë bashkëpunim*. Kjo është shqetësuese, pasi punonjësit e Qeverisë janë të kyçur në trafikim.

Ndërsa nga Raporti i *Freedom House*, paraqitet nevoja që të kërkojmë nga Drejtoria për Inteligjencë dhe Analiza në kuadër të MPB-së, disa elemente që do ti nevojiteshin Komisionit për ti shqyrtuar në të ardhmen, prandaj konsideroj se një kërkesë e tillë duhet ti bëhet MPB-së, për krimin e organizuar, trafikimin me narkotik dhe trafikimin me qenie njerëzore.

Gjithashtu kohëve të fundit është parë shtimi i numrit të radikalizmit dhe ekstremizmit dhe për këtë qëllim të kërkohej raport, gjithashtu edhe për çështjen e korrupsionit të resorit që mbulohet nga Komisioni.

Tutje hapi debatin për këtë çështje.

Fatmir Xhelili- Duke iu referuar raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit tha se tek trafikimi me qenie njerëzore janë disa specifika në bazë të cilave bëhet klasifikimi i shteteve që bëhen nga ana e SHBA-së, për shtete që arrijnë standardet minimale në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore.

Konsideroj se Kosova ka arritur në krijimin e mekanizmave policor, hetimor dhe gjyqësor në luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, gjithashtu është një avancim edhe shkalla e ndëshkueshmërisë e cila parashihet në Kodin Penal, ku përcaktohen dënime të larta për subjektet e përfshira në trafikim.

E vlerësoj si përparësi krijimin e këtyre mekanizmave dhe është çështje e krahasimit të viktimave, pasi edhe për viktimat janë marrë masat adekuate për trajtimin e tyre. Pasi të gjitha pikat që u përmendën, krimi i organizuar, korrupsioni, trafikimi me qenie njerëzore dhe narkotik, propozoj që për secilën pikë, të organizonim dëgjim në komision, duke ftuar edhe akter të tjerë, duke dal me rekomandim të komisionit për çështjen që është diskutuar. Gjithashtu këto çështje do duhej të diskutoheshin edhe në Kuvend.

Prandaj konsideroj se institucionet përgjegjëse duhet të marrin seriozisht luftimin këtyre fenomeneve, të cilat rrjedhin edhe nga strategjitë e krijuara për këtë qëllim, si dhe një nismë nga komisioni për të diskutuar për këto çështje e konsideroj të arsyeshme dhe e përkrah, duke ftuar akterët që kontribuojnë në këtë fushë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Prokurori, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Ministrinë e Drejtësisë.

Rexhep Selimi- Për të parë më afër këtë proces, do të duhej të fillonim nga institucionet që mbikëqyren nga Komisioni, Ministria e Punëve të Brendshme dhe mekanizmat që mbulon ajo, dhe më pas të organizoheshin dëgjime të tjera.

Fatmir Xhelili- Vlerësoi se një nismë e tillë nga Komisioni për të diskutuar për këto çështje, do të sensibilizonte gjyqësorin dhe prokurorin për tu marrë më seriozisht me këto çështje, nga fillimi i hetimit të këtyre çështjeve deri te shkalla e lartë e ndëshkimit për akterët e përfshirë. Prandaj vlerësoj që Kuvendi do të ndihmonte që këto institucione të kishin përkrahjen politik për të bërë punën e tyre.

Rexhep Selimi- Vlerësoi se në kuadër të funksionit mbikëqyrës, Komisioni duhet të thërras institucionet që mbikëqyr për përgjegjësi, ndërsa sa i përket iniciativave parlamentare si deputet do të mund të ndërmerrem dhe do të përkrahja. Por përgjegjësia fillimisht të kërkohej nga institucionet përgjegjëse pastaj nga institucionet e tjera.

Fatmir Xhelili- Konsideroi se krimi i organizuar dhe korrupsioni mund të konsiderohet si dy çështje që kanë rrezikshmëri për funksionimin e shtetit në të ardhmen, marrë në konsideratë që jemi Komision që mbulojmë sektorin e sigurisë.

Kryetari i Komisionit- Nëse pajtoheni mund të kërkojmë informatë nga Ministria e Punëve të Brendshme për këto çështje, pastaj mund të vazhdohet me angazhime të tjera nga ana e Komisionit, siç mund të jetë dëgjimi publik për këtë çështje.

Fatmir Xhelili- Vlerësoi se raportet nga Ministria e Punëve të Brendshme janë për periudhën tre mujore, gjashtë mujore dhe një vjeçare, të cilat janë gjithëpërfshirëse me tepër se informata që mund të kërkohej, prandaj mund të fillohet duke ftuar akterët përkatës në Komision për çështje të caktuara.

Ganimete Musliu- Me që çështjet që po diskutohen dhe për shkak të rëndësisë së tyre, konsideroj se trajtimi i tyre duhet të bëhet si pika të veçanta të rendit të ditës për mbledhjet e Komisionit, duke mos i trajtuar në pikën të ndryshme.

Kryetari i Komisionit- Konsideroj se në bazë të veprimeve që kanë ndodhur ditëve të fundit, nëse do të kishim një informatë për këto çështje do të na ndihmonte për trajtimin e këtyre çështjeve, siç është krimi i organizuar ose trafikimi me qenie njerëzore.

Vjollca Krasniqi- Duke iu referuar raportit të Departamentit të Shtetit Amerikan për çështjet e trajtuar, konsideroj se do të ishte e nevojshme edhe një informatë për këto çështje, siç është trafikimi me qenie njerëzore, informatë e cila do të na ndihmonte në trajtimin e kësaj çështje dhe që është trajtuar nga raporti i DASH.

Goran Marinković- Pajtohem me anëtarët që këto çështje duhet trajtuar nga ana e Komisionit dhe konsideroj se këto çështje janë shumë të ndjeshme dhe konsideroj se si Komision duhet ti parashtrijmë disa pyetje ndaj institucioneve përkatëse që të marrim përgjigjeje, dhe më pas të organizojmë dëgjim publik duke i ftuar akterët relevant, ku të ftuar do të jenë shoqëria civile, media, ku çështjet që do të trajtohen do të jenë veriu i Kosovës, trafikimi me qenie njerëzore, tregtia e paligjshme etj.

Kryetari i Komisionit- Duke iu referuar raporteve ndërkombëtare, të DASH dhe *Freedom House* dhe çështjet të cilat janë trajtuar nga këto raporte, siç është korrupsioni, radikalizmi dhe ekstremizmin e shtuar, krimi i organizuar dhe trafikimi me qenie njerëzore, konsideroj se për këto çështje do të ishte mirë të kishim një informatë nga Ministria e Punëve të Brendshme, duke vazhduar tutje me aktivitetet të tjera nga ana e Komisionit, siç mund të jetë dëgjimi publik për këtë çështje ose debat në Kuvendin e Kosovës.

Anton Quni- Vlerësoi se institucioni adekuat dhe i besueshëm që do të mund të bënte një vlerësim për këto çështje në rastin e Kosovës dhe të jepte një informatë do të ishte Agjencia e Kosovës për Inteligjencë e cila bënë kategorizimin e rreziqeve, dhe më pas nga kjo informatë të bëjë një krahasim me të gjeturat e raporti i DASH dhe *Freedom House* dhe a vepron Policia e Kosovës sipas kategorizimit të çështjeve që janë bërë.

Kryetari i Komisionit- Vlerësoi se informata nga AKI-ja mund të kërkohej në kuadër të bashkëpunimit, pasi nuk hynë në kuadër të fushëveprimit të Komisionit, por kjo kërkesë

mund të bëhet edhe përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme të cilët kanë bashkëpunim me agjencionin përkatës.

Fatmir Xhelili- Duke iu referuar propozimit të z. Quni, konsideroj se një kërkesë e tillë mund ti bëhet Policisë së Kosovës, Drejtorisë për Analizë të Krimeve dhe Rreziqeve, të cilët do të dilnin me vlerësime reale për këto çështje.

Kryetari i Komisionit- Nga debati për këtë çështje, në emër të Komisionit mund të kërkojmë informatë nga Ministria e Punëve të Brendshme për çështjen e krimit të organizuar, trafikimit me qenie njerëzore dhe narkotik si dhe radikalizmit dhe ekstremizmit në rritje, duke vazhduar më pas me aktivitetet vijuese për këtë çështje nga ana e Komisionit.

Gjithashtu njoftoi se nga data 24-26 qershor, anëtarët e Komisionit do të jenë në Ohër, për tryezën organizuar nga DCAF, dhe ftoi anëtarët për kontributin e tyre në këtë tryezë.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi